



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 3888 / Prot. 11

Patos, më 23.10.2024

**MIRATOHET
KRYETARI
Fation Duro**

PROJEKTVENDIM

Nr. 77, datë 23.10.2024

**“PËR
DHËNIEN NË HUAPËRDORJE TË NJË AMBIENTI TË NDODHUR NË
PASURINË ME NR. 104/2/A, ZK 3361, SHEQISHTE KATI II, ORGANIZATËS
“GRUPI VENDOR I VEPRIMIT ITEA PATOS ” SIPAS PLANVENDOSJES
BASHKËLIDHUR”**

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Mbështetur në shkronja e/1 të nenin 54 të ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar me ligjin nr. 38/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 901 e në vijim të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, VKM nr. 432, datë 15.05.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Zharrëz, të qarkut të Fierit”, Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr. 83, datë 18.12.2023 “Për miratimin e anëtarësimit në grupin vendor të veprimit në bashkinë Patos.....” , kërkesës së paraqitur prej Grupit Vendor të Veprimit Itea Patos nr. 3888 prot., datë 23.10.2024 i kërkojmë Këshillit të Bashkisë Patos;

1. Të miratojë dhënien në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/a, zk 3361 me sipërfaqe 30.82 m², në fshatin Sheqishte kati II, organizatës Grupi Vendor i Veprimit Itea Patos, sipas planvendosjes bashkëlidhur, pa kundërshtim dhe për një afat të pacaktuar.
2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të përdoret për seli për aktivitetin e Grupit Vendor të Veprimit Itea Patos.
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Patos, për nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes më GVV Itea Patos .

Drejtoresha e P. ZH. Territorit
Boreta Murati

Juriste
Nurkë Hazizaj

Specialist Urbanist
Franceska Gjata

Adresa: Lagja “Nalltani”, Rruga “Unaza”, Patos



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS

Nr. 3888 Prot.
2

Patos, më 23.10.2024

RELACION

“PËR

DHËNIEN NË HUAPËRDORJE TË NJË AMBIENTI TË NDODHUR NË PASURINË ME NR. 104/2/A, ZK 3361, ME SIPËRFAQE 30.82 M², NË FSHATIN SHEQISHTE KATI II, ORGANIZATËS “GRUPI VENDOR I VEPRIMIT ITEA PATOS ” SIPAS PLANVENDOSJES BASHKËLIDHUR”

KËSHILLIT TË BASHKISË PATOS

Pranë bashkisë Patos është depozituar kërkesa nr. 3888 prot., datë 23.10.2024 e organizatës “Grupi Vendor i Veprimit Itea Patos ” për dhënie në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/a, zk 3361 në fshatin Sheqishte.

Në këtë shoqatë është e anëtarësuar edhe bashkia Patos, e miratuar me Vendimin e Këshillit të Bashkisë nr. 83, datë 18.12.2023 “Për miratimin e anëtarësimit në grupin vendor të veprimit në bashkinë Patos dhe miratimin në parim të marrëveshjes së patneritetit si bashkëthemelues dhe autorizimin e Kryetarit të Bashkisë për firmosjen e marrëveshjes së patneritetit”.

Shoqata “Grupi Vendor i veprimit Itea Patos” është regjistruar si organizatë jofitimprurëse në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë me vendimin nr. 7428, datë 10.10.2024.

Kjo shoqatë për t’u regjistruar në Drejtorinë e Tatimeve ka të nevojshme pasjen e një ambienti për t’u përdorur si seli qendrore.

Pasi ekzekutivi shqyrtoi kërkesën e paraqitur dhe për të bërë të mundur regjistrimin në Drejtorinë e Tatimeve të organizatës “Grupi Vendori Veprimit Itea Patos ” i kërkojmë Këshillit të Bashkisë:

1. Të miratojë dhënie në huapërdorje të një ambienti të ndodhur në pasurinë me nr. 104/2/a, zk 3361 me sipërfaqe 30.82 m², në fshatin Sheqishte kati II, sipas planvendosjes bashkëlidhur, pa kundërshtim dhe për një afat të pacaktuar.
2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të përdoret për seli për aktivitetin e Grupit Vendor të Veprimit (GVV).
3. Të autorizojë Kryetarin e Bashkisë Patos, për nënshkrimin e kontratës së huapërdorjes me GVV Itea Patos.

Drejtoresha e P. ZH. Territorit
Boreta Murati

Juriste
Nurkë Hatizaj

Specialist Urbanist
Francëska Gjata

KRYETARI
Fation Duro




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
Adresa :Lagja "Natëtar"Rruga "Unaza"

PLANVENDOSJA PËR AMBIJENTIN QË DO TI JEPET NË HUAPERDORJE ORGANIZATËS "GRUPI VENDOR I VEPRIMIT ITEA PATOS".

E ndodhur në pas. me nr. 104/2/A, me sipërfaqe 30.82m², fshati Sheqishte, Zona Kadastrale 3361, PATOS.

Bazuar ne VKM Nr.443,date 15/06/2016 dhe sipas matjeve te kryera ne terren.



Kjo planvendosje është e vlefshme vetëm për kontrat huapërdorje.

Sh 1:1000



MIRATOHET

KRYETARI I BASHKISE

FATON DURO

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE

ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

BORETA MURATI

ING. TOPOGRAF

MARSILDA LIZAJ

